

1 E enjte, 5 dhjetor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, kjo është

8 lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim

9 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

11 Vërej që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në

12 sallën e gjyqit.

13 Do të vijojmë me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorit

14 W04401.

15 Përpara se të vijë dëshmitari, do të doja të pyesja ZPS-

16 në nëse është gati të na thotë diçka lidhur me dëshmitarët për

17 bllokun e ardhshëm të dëshmive. Do të doja të na thoni jo

18 vetëm cilët do të jenë, por dhe rendin.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Tani nuk mund tua jap këtë

20 informacion, por do të përpiqem që informacionin tua jap sot.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

22 [Përkthim] Mesa mbaj mend unë duhet ta kishit dhënë sot

23 këtë informacion.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Po, sot, por nuk e di a e doni

25 tani.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, mjafton  
2 brenda orarit zyrtar të punës.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

4 Trupi Gjykses do të nxjerrë një urdhër me gojë sa i takon  
5 kundërshtimit që bëri avokati i z. Veseli lidhur me një  
6 dokument që ka përdorur Trupi Gjykses gjatë pyetjeve të veta.

7 Ju lutem Sekretarisë të na kalojë në seancë private.

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15 [Seancë e hapur]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi në  
17 seancë publike.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 [Dëshmitari vijon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për  
21 procesverbal i pranishëm në sallën e gjyqit është edhe avokati  
22 kujdestar. Mirëmëngjesi, Avokat.

23 Z. Bashota, mirëmëngjesi.

24 DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi ende

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç (Vazhdim)

Faqe 7

1 disa pyetje për ju, por unë jam i bindur që kjo do të jetë  
2 dita e fundit në sallën e gjyqit për ju. Besoj se do ju bëhet  
3 qejfi ta mësoni këtë gjë.

4 Vazhdoni, z. Misetiç.

5 DËSHMITARI: SOKOL BASHOTA [Vijon]

6 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç:

7 [Vazhdim]

8 Z. MISETIC: [Përkthim]

9 PY. Mirëmëngjesi, z. Bashota.

10 PË. Mirëmëngjes.

11 PY. Unë do të doja të flasim për një temë që u trajtua nga  
12 Trupi Gjykses. Bëhet fjalë për mënyrën se si janë marrë  
13 vendimet në Shtabin e Përgjithshëm. Do t'ju tregoj disa  
14 dokumente dhe do t'ju bëj disa lidhje -- disa pyetje lidhur me  
15 procesin, më falni.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të vendosim në ekran  
17 provën materiale që mban numrin P00621 si në shqip dhe në  
18 anglisht. Është në listën e përditësuar të materialeve.

19 PY. Dëshmitar, e shihni dokumentin në ekran? Pretendohet se  
20 është një urdhër i lëshuar nga Bislir Zyrapi në cilësinë e  
21 shefit të Shtabit të Përgjithshëm. Fillimisht do t'ju pyes për  
22 një fjalë që del tek shqipja. Te pika numër 1, është një fjalë  
23 në shqip "referimit". A mund të na e shpjegoni ju çfarë është  
24 "referimit"? Çfarë nënkupton fjala "referimit"?

25 PË. Unë si fjalë them muj me e --

1 PY. Referimi, ë.

2 PË. Referim, duhet me referu, me paraqit një diçka. Po ç'ka  
3 dasht me thanë këtu z. Zyrapi nuk po muj me e dit. Sikur me  
4 paraqit diçka, apo me --

5 PY. Po, raportim, domethënë. Në shqip nëse unë e lexoj saktë  
6 -- shikoni ju lutem paragrafin e parë. Kush e ka lëshuar këtë  
7 urdhër?

8 PË. Këtu po del se Bislīm Zyrapi.

9 PY. Po. Dhe ai te pika 1 ka urdhëruar që kryeshefët e  
10 drejtorive t'i raportojnë, duhet ta kishte pas dhe anglishtja:  
11 "... duhej t'i raportojnë në orën 12.00 në selinë e [SHP-  
12 së] do të mbahet referimi, raportimi me kryeshefët e  
13 drejtorive të [SHP-ve] të UÇK-së."

14 Saktë?

15 PË. Po.

16 PY. Ai është presoni që ka urdhëruar referimin, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. E ka lëshuar vetë këtë urdhër ai?

19 PË. Me siguri ai, përderisa është edhe emri i tij poshtë dhe  
20 në atë shkrun këtu për drejtorinë, që është urdhër i tijna.

21 PY. Po. Ai nuk e ka lëshuar urdhrin pa u konsultuar  
22 paraprakisht me anëtarët e tjerë të Shtabit të Përgjithshëm  
23 për të parë nëse mund ta lëshonte apo jo këtë urdhër. E saktë?

24 PË. Besoj se ka pas mundësi me e lëshu këtë urdhër edhe vetë,  
25 përderisa ka qenë kryeshef edhe është nënshkruesi i këtij



1 urdhri.

2 PY. Shohim një dokument tjetër.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarisë, gjendet në  
4 listën e parë të materialeve, në listën fillestare të  
5 materialeve. Është materiali numër 1D29.

6 PY. Z. Bashota, shihni dokumentin në të majtë të ekranit dhe  
7 më thoni a e keni parë ndonjëherë më përpara këtë dokument?

8 PË. Unë personalisht s'e kam pa.

9 PY. Nëse e sheh dokumentin, a mund të na thoni kush e ka  
10 lëshuar këtë urdhëresë?

11 PË. Bislim Zyrapi.

12 PY. E ka lëshuar në bazë të kompetencave të tij, mesa keni  
13 mundësi të na thoni, në bazë të dokumentit. E ka lëshuar në  
14 bazë të kompetencave që kishte ai apo është konsultuar me  
15 Shtabin e Përgjithshëm dhe e ka nxjerrë këtë dokument në emër  
16 të organit kolektiv?

17 PË. Ka mujt me e lëshu vetë këtë urdhëresë.

18 PY. Shihni pikën 4, ju lutem. Shihni pikën 1, thohet:

19 "Ndalohet arrestimi, paraburgimi ose burgosja e personave  
20 pa urdhër nga -- pa urdhër të komandantit të brigadës e më  
21 lart, vetëm në raste kritike dhe situatave luftarake apo kur  
22 kryhen vepra penale të ndryshme, si ndaj pjesëtarëve të UÇK-  
23 së, ndaj individëve dhe pushtetit civil."

24 Këtë e ka lëshuar në bazë të kompetencave të tij  
25 personale?

1 PË. Nuk muj me paragjy këtë, nuk e di. Po që ka pas mundësi  
2 me lëshu këtë po, e ka bo, ka lëshu. Është një urdhëresë e  
3 Bislum Zyrapit. Saktë s'po muj me e dëshifru krejt qëllimin e  
4 saj, por realisht është e tijna.

5 PY. Do t'ua bëj pyetjen ndryshe. Me ju personalisht a është  
6 konsultuar përpara se ta lëshonte urdhëresën, më konkretisht  
7 pikën 4?

8 PË. Jo.

9 PY. Mesa keni ju dijeni, a është konsultuar me ndokënd tjetër  
10 në Shtabin e Përgjithshëm? Gjithmonë se mesa keni ju dijeni.

11 PË. S'kam dijeni për këtë.

12 PY. Në rregull. Atëherë, ju nuk keni arsye për të besuar që  
13 ky ka qenë një vendim kolektiv i Shtabit të Përgjithshëm?

14 PË. Jo, jo, këtë e ka pas mundësitë Bislumi, përderisa është  
15 poshtë me emrin e tijna dhe është e drejtë e tijna.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarisë, në listën e  
17 re të materiale mund të nxirrni materialin P628.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam një pyetje. Pak vonë,  
19 por më falni që po jua bëj këtë pyetjen. Kam një pyetje për  
20 dokumentin P00261.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] 621.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po, 621, ju kërkoj ndjesë.  
23 S'e kam për dëshmitarin, e kam për ju pyetjen. Atëherë, a  
24 është qëndrimi juaj që ky dokument nuk ka një referencë për  
25 një takim? Fjala "referimi", keni dashur të thoni që ka pasur

1 një takim?

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Në fakt do t'i kërkojmë  
3 Prokurorisë të bëjnë një korigjim përkthimi. Duhej të ishte  
4 reflektuar edhe fjala "referim" tek anglishtja.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull.

7 Atëherë vendosim në ekran provën P628.

8 PY. Po ky dokument, z. Dëshmitar? Kush e ka lëshuar këtë  
9 dëshmitar?

10 PË. Edhe këtë dokument del që e ka bërë z. Bislir Zyrapi.

11 PY. Këtë e ka bërë në bazë të kompetencave të tij personale,  
12 individuale?

13 PË. Po.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim tani në ekran provën me  
15 numrin P620 -- 30, më falni.

16 PY. Po këtë dokument kush e ka lëshuar?

17 PY. Edhe ky është një dokument i dalun nga Bislir Zyrapi.  
18 Kështu po shkrun.

19 PY. Mesa mund të na thoni ju, e ka lëshuar këtë dokument në  
20 bazë të kompetencave të tij individuale, apo është kjo një  
21 urdhëresë kolektive e Shtabit të Përgjithshëm?

22 PË. Jo, nuk kam njohuri se është një urdhëresë e Shtabit të  
23 Përgjithshëm, po kjo është individuale e Bislir Zyrapit.

24 PY. A kam të drejtë kur them se Bislir Zyrapi - më falni, se  
25 Bislir Zyrapi në cilësinë e shefit të Shtabit të Përgjithshëm

- 1 ka lëshuar urdhëresa operative për UÇK-në?
- 2 PË. Unë përpos urdhëresa operative po shoh se ka dhe  
3 urdhëresa të tjera. E nuk i di urdhëresat e z. Bislime Zyrapi  
4 çfarë i ka lëshu, kryesisht që kanë të bëjnë me komandën e  
5 zonave, por nuk ja di tekstin e tyre, nuk ja di përmbajtjen e  
6 tyre dhe s'po muj me kualifiku nëse është për çështje  
7 operative dhe pse ai ka qenë i fushës. Po s'muj me akceptu  
8 këto dy-tri vendimet, urdhrat, urdhëresat e tijna. Po  
9 kryesisht shihet që ju ka dërgu komandantëve të zonave, shihet  
10 këtu për çështje të ndryshme.
- 11 PY. Në përgjigjen tuaj të fundit ju thatë:  
12 "Nuk e di se çfarë urdhëresash lëshonte Bislime Zyrapi."  
13 Si ka mundësi që nuk e dini ju se çfarë urdhëresash  
14 lëshonte ai? Pse nuk e dini këtë gjë?
- 15 PË. Se s'më ka pyet kurrë.
- 16 PY. Pra, Bislime Zyrapi ka lëshuar urdhra pa e mbledhur  
17 Shtabin e Përgjithshëm, pa u konsultuar me Shtabin e  
18 Përgjithshëm, sepse ju vetë keni qenë anëtar i Shtabit të  
19 Përgjithshëm, apo jo?
- 20 PË. Unë jo çdo herë kam qenë pjesëmarrës në takimet e Shtabit  
21 të Përgjithshëm. Por në këtë takim për -- sa herë unë kam  
22 qenë, nuk e kam pa një urdhëresë të tillë të Bislime Zyrapit.  
23 thjesht ky relacion është i tijna me komandantët e zonave dhe  
24 realisht [E pakuptueshme] as nuk është konsultu me mu, as me -  
25 - nuk e di nëse është konsultu me dikënd të Shtabit të

1 Përgjithshëm, por s'e besoj. Ka pas autoritetin me i bo vetë.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Po më thonë që në transkriptin në  
3 faqen 11, rreshti 24, duhet të thotë, duhet të thuhet, duhej  
4 të ishte thënë "Ky nuk është një urdhër i Shtabit të  
5 Përgjithshëm", sepse këtë ka thënë dëshmitari. Të paktën unë  
6 kështu e dëgjova me vesh. Thjesht në transkript nuk është  
7 reflektuar kështu.

8 PY. Në rregull. Flasim për diçka që është pasqyruar në  
9 transkriptin e përkohshëm, faqja 85. Është një pyetje që ju  
10 bëri Gjykatësi Mettraux dje. Ishin shembujt që kishte dhënë  
11 Rexhep Selimi për vendimet kolektive. Unë do t'ju bëj pyetje  
12 lidhur me disa nga këto vendime. Një syresh është emërimi i  
13 Adem Demaçit me vendim kolektiv të Shtabit të Përgjithshëm.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Do lutesha të vendoset në ekran  
15 prova materiale që mban numrin 1D50.

16 PY. Ju kujtohet që unë para disa ditësh ju pyeta për emërimin  
17 e Adem Demaçit dhe ju u përgjigjët dhe thatë që ju  
18 personalisht nuk keni marrë pjesë në atë vendim, kështu?

19 PË. Po.

20 PY. Kjo është Deklarata Politike numër 7, ku është shpallur  
21 fakti që ishte emëruar Adem Demaçi si përfaqësues politik.  
22 Shohim në fund datën e dokumentit. Datën që është lëshuar ky  
23 dokument. Data është 13 gusht 1998. E shihni?

24 PË. Po.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani shkojmë në provën materiale

1 P653. Edhe ky është një dokument tjetër që ja u kam treguar  
2 gjatë kohës që ju bëra pyetjet e mia.

3 PY. Ishin shënime të pretenduara të Shtabit të Përgjithshëm  
4 në verën e 1998-s. Shënime të një takimi të pretenduar, më  
5 falni.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Më jepni dhe një herë  
7 numrin, ju lutem.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] P00653. Duhet të jetë në listën  
9 tonë fillestare, por dhe në listën e Prokurorisë. Kërkoj  
10 ndjesë, jua dhashë numrin gabim. Më duket se është me numër  
11 643. Në faqen tjetër, ju lutem.

12 PY. Po ta shihni është në fillim një takim në 23 korrik dhe  
13 takimi i radhës, të paktën në këtë shënim që shohim ne, është  
14 16 gusht 1998. E shihni?

15 PË. Po.

16 PY. Pra, sipas këtij blloku shënimesh Shtabi i Përgjithshëm  
17 është takuar vetëm tri ditë pasi është bërë publik emërimi i  
18 Adem Demaçit. Pajtoheni?

19 PË. Nuk e di këtë.

20 PY. Të paktën nëse do të marrim parasysh bllokun e shënimeve,  
21 nëse do të mbështetemi në këtë bllok shënimesh, a pajtoheni me  
22 mua që i takon që Shtabi i Përgjithshëm të mos jetë takuar  
23 deri tre ditë pas emërimit publik të Adem Demaçit, shpalljes  
24 publike, më falni, të Adem Demaçit dhe ju personalisht ndër të  
25 tjerët, keni qenë përfaqësues politik të UÇK-së?

1 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtoj. Shtrembëron provat.

2 Dëshmitari dhe z. Demaçi përmenden në paragrafë të ndryshëm të  
3 dokumentit në fjalë.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Është në të njëjtin dokument.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kanë qenë përfaqësues politikë  
6 të barabartë, dhe z. Demaçi në fakt nuk përmendet këtu si i  
7 emëruar zyrtarisht në provën, të paktën, në provën 1D50.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk është i renditur si -- nuk  
9 përmendet këtu si emëruar zyrtarisht? A e dëgjova unë siç  
10 duhet?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Po nuk thuhet këtu që është  
13 emëruar zyrtarisht.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull.

15 PY. Ai është shpallur si përfaqësues politik tri ditë përpara  
16 një mbledhjeje që pretendohet se është mbajtur më 16 gusht  
17 atëherë, saktë?

18 PË. Ka mundësi. Unë nuk po muj me e dëshifru këtë shkrim që  
19 është me dorë dhe nuk di nëse përmendet dikund Adem Demaçi në  
20 këtë që e kam në ekran. Në këtë shkrim s'po e shoh.

21 PY. Jo, nuk përmendet. Kështu që do t'ju pyes dhe një herë  
22 dhe po ju jap dhe qëndrimin tim. Siç e kuptova unë dëshminë  
23 tuaj gjatë kundërpvetjeve të mia, ju drejtpërsëdrejti nuk e  
24 dini se si është emëruar z. Adem Demaçi si përfaqësues politik  
25 i UÇK-së. Saktë?

1 PË. Saktë.

2 PY. Diçka tjetër që ka përmendur z. Selimi si vendim kolektiv  
3 ka qenë vendimi për të marrë pjesë në konferencën e Rambujesë.  
4 Ju keni marrë pjesë në ndonjë mbledhje ku është diskutuar  
5 pjesëmarrja në konferencën e Rambujesë?

6 PË. Me sa më kujtohet, po.

7 PY. Kush ka qenë i pranishëm në këtë takim apo takime?

8 PË. Me thonë të drejtën tash nuk muj me i dit me emër se  
9 kush. Po e di që është diskutuar, nuk e di tash në cilën [E  
10 pakuptueshme] është diskutuar për shkuarjen në Rambuje mbas  
11 dokumentit të Hillit që e kemi diskutuar disa herë. Pastaj ka  
12 ardh kjo ideja për konferencën e Rambujesë. Po unë nuk i di  
13 emrat kush i ka përcaktu emrat për me shku në Rambuje, kush i  
14 ka përzgjedh emrat për me shku në Rambuje.

15 PY. Kjo ishte pyetja ime e radhës, në fakt. Në takimet që ju  
16 keni marrë pjesë në Shtabin e Përgjithshëm nuk keni diskutuar  
17 dhe nuk i keni caktuar se kush do ishin përfaqësuesit e UÇK-së  
18 në konferencë. A është e saktë kjo?

19 PË. E saktë është.

20 PY. Pra, dikush tjetër duhet të ketë pas autoritetin ose  
21 kompetencën për emërimin e përfaqësuesve të UÇK-së në  
22 delegacion, kështu? E saktë?

23 PË. Po.

24 PY. Ju sipas jush, domethënë, kush e kishte këtë kompetencë?  
25 Kush e kishte këtë autoritete?



1 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtoj.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Do e ndryshoj pyetjen.

4 PY. Mbështetur në përvojën tuaj dhe në faktin që keni qenë  
5 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, sipas jush kush pritej ose  
6 kush mendoni ju që ka qenë personi që ka bërë caktimet për në  
7 delegacion?

8 PË. Po realisht këtë ka mujt me e bo Azem Sylja.

9 PY. Sa i takon takimeve ku është diskutuar kjo, këto takime  
10 do kenë ndodhur diku afër Rambujesë? Si mendoni?

11 PË. Përafërsisht, po. Kur është dhënë ideja për këtë  
12 konferencën.

13 PY. Trupi Gjykues ka dëgjuar dëshmi që z. Thaçi nuk ka qenë  
14 në Kosovë prej datës 16 nëntor deri me datë 10 mars. Pyetja që  
15 kam për ju është kjo: Në qoftë se z. Thaçi nuk ka qenë në  
16 Kosovë, kush i ka bërë këto biseda brenda Shtabit të  
17 Përgjithshëm sa i takon konferencës së Rambujesë dhe kush do  
18 të marrë pjesë në atë konferencë?

19 PË. Po këto kryesisht i kemi diskutuar me përfaqësues  
20 ndërkombëtarë në atë kohë, edhe për idenë e kësaj konference,  
21 për formën e saj se si duhet të jetë kjo konferencë, me Shaun  
22 -- të paktën më kujtohet një takim që e kemi pas me Shaun  
23 Brynes për këtë çështje. Kryesisht me të.

24 PY. A ju kujtohet ndonjë takim ose e kam fjalën këtu për  
25 ndonjë takim të brendshëm të UÇK-së, ju kujtohet ndonjë takim

1 i tillë i kësaj natyre ku ka pasur biseda për të marrë pjesë  
2 në konferencën e Rambujesë?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kemi treguar  
4 durim sepse janë bërë pyetje lidhur me vendimmarrjen e Shtabit  
5 të Përgjithshëm nga Gjykatës, megjithatë nuk mund të lejojmë  
6 çdo lloj pyetje të mundshme të bërë nga avokat sa i takon  
7 vendimeve, të gjitha vendimeve të mundshme të Shtabit të  
8 Përgjithshëm.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, ky diskutim në  
10 fakt është cituar dhe nga Gjykatësi Mettraux dhe për këtë  
11 arsye po e bëj pyetjen.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem  
13 përgjigjuni, Dëshmitar.

14 Rrëzohet kundërshtimi.

15 Z. MISETIC: [Përkthim]

16 PY. Doni t'ja u përsëris dhe një herë, Dëshmitar, apo e  
17 kuptuat?

18 PË. Jo, edhe një herë të lutna se --

19 PY. A ju kujtohet ndonjë takim, domethënë e kam fjalën këtu  
20 për takime të brendshme të UÇK-së ku ka pas biseda në qoftë se  
21 do merrej pjesë në konferencën e Rambujesë, apo jo?

22 PË. Specifikisht nuk më kujtohet se kemi pas një takim. Nuk e  
23 di. Nuk e mbaj mend.

24 PY. Në rregull. Dhe pika e fundit që është ngritur nga z.  
25 Selimi dhe që për të cilën ju bënë pyetje Gjykatësit, më

1 konkretisht Gjykatësi Mettraux dhe që dua ta diskutoj me juve,  
2 ka të bëjë me marrëveshjen për emërimin e kryeministrit të  
3 Qeverisë së Përkohshme të Kosovës. Pyetja që kam për ju është  
4 kjo: A keni marrë pjesë në një takim ku është diskutuar  
5 emërimi i kryeministrit i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës?  
6 PË. Nuk po e di saktë në qoftë se është ai takimi me  
7 komandantët e zonave që a kon një takim. Nuk e di a është  
8 diskutu aty, po une me sa e mbaj mend si propozim, për me  
9 udhëheq delegacionin në Rambuje është marrë -- z. Thaçi është  
10 marrë më duket atje në Rambuje edhe nuk e di nëse është  
11 vendosun në Rambuje kjo apo jo. Dhe neve veç na është  
12 transmetu si propozim që është bërë për z. Thaçi si i nominuar  
13 për kryeministër i Qeverisë së Përkohshme.

14 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

15 Z. MISETIC: [Përkthim]

16 PY. Kam edhe një pyetje tjetër lidhur me vendimmarrjen  
17 kolektive dhe do ju pyes në qoftë se bëhet fjalë për një organ  
18 kolektiv dhe më konkretisht do ju pyes lidhur me rolin e z.  
19 Thaçi në Shtabin e Përgjithshëm.

20 Mesa dini ju, Dëshmitar, a mund të lëshonte urdhra z.  
21 Thaçi për ushtarët në zona?

22 PË. Jo.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Për Trupin Gjykses kjo është një  
24 pyetje e cila lidhet me një dokument që e kemi në listën tonë  
25 të dokumenteve, që ka numrin DHT704920 deri në DHN704921, që

1 ka të bëjë me relevancën e kësaj piste pyetjesh.

2 PY. A mund të lëshonte ai urdhra për njerëzit të cilit mund  
3 të kenë qenë duke ndaluar bashkëpunëtorët e pretenduar? Mund  
4 të jepte urdhra për personat që ndalonin bashkëpunëtorët e  
5 pretenduar ai?

6 PË. Jo.

7 PY. Tani do kalojmë te tema e fundit që dua të diskutoj me  
8 ju. Është tema që ka të bëjë me intervistën e Azem Sylës.  
9 Pyetjet lidhur me të ju bënë nga Gjykatësi Mettraux.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal dokumenti mban  
11 numrin e provës P847. Ndërkohë dokumenti mban datën 2 tetor  
12 1999. E kuptoni këtë, Dëshmitar? Domethënë disa muaj pas  
13 përfundimit të konfliktit. Në qoftë se ju kujtohet Gjykatësi  
14 Mettrax ju bëri pyetje lidhur me intervistën e Azem Sylës ku  
15 ai ka thënë me emër dhjetë persona anëtarë fillestarë të  
16 Shtabit të Përgjithshëm. A ju kujtohen këto pyetje, Dëshmitar/  
17 PË. Po.

18 PY. Ajo çfarë po ju them unë tani, është që nuk është e  
19 nevojshme që ta tregojmë dokumentin në ekran, megjithatë po ju  
20 thoja që ky është një dokument ose kjo është një intervistë e  
21 cila është botuar me datën 2 tetor 1999. A e kuptoni këtë,  
22 Dëshmitar?

23 PË. Po.

24 PY. Z. Sylë e dha këtë intervistë ndërkohë që partitë  
25 politike po krijoheshin në Kosovë pas konfliktit. A është e

1 saktë kjo?

2 PË. Po.

3 PY. A është e saktë po ashtu që ju keni qenë një prej  
4 themeluesve ose anëtarëve kryesorë të partisë PDK?

5 PË. Po.

6 PY. Atëherë, intervista me 2 tetor 1999, kjo është data. A ju  
7 kujtohet që z. Thaçi e ka njoftuar formalisht krijimin e  
8 partisë PDK vetëm disa ditë pasi z. Sylja e ka dhënë këtë  
9 intervistë. A ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

10 PË. Për datat nuk i di saktë, por e di se kam qenë prezent ku  
11 është themelur Partia Demokratike e Kosovës.

12 PY. Në rregull. Qëndrimi ynë është që partia është themeluar  
13 në fillim të tetorit 1999, dhe ju keni qenë një ndër personat  
14 themelues të partisë ose një ndër personat fillestarë të  
15 krijimit të saj.

16 Është gjithashtu e vërtetë që edhe z. Sylja vetë u bë  
17 pjesë e PDK-së, anëtar i PDK-së. A është e saktë kjo,  
18 Dëshmitar?

19 PË. Po, e saktë.

20 PY. A ka qenë përvoja jua në këtë Kosovë që njerëzit e kanë  
21 zmadhuar, e kanë zbukuruar rolin e vet dhe rolin e personave  
22 të tjerë për qëllime politike në Kosovë?

23 PË. I nderuar avokat, mbas luftës janë nxjerrë edhe libra  
24 shumë, janë nxjerrë edhe intervista shumë. Realisht  
25 gjithsecili i ka bërë glorifikimin e gjithë procesit apo të

1 periudhës së kohës së luftës, por patjetër se në to ka pas  
2 edhe egoizma, mendoj të tepruar, duke ja mveshur vetes meritat  
3 ndoshta që realisht edhe nuk i kanë pasur. Thjesht për të qenë  
4 sa më ofertues për qytetarin, me siguri dhe për mbledhjen e  
5 votave apo për qëllime të caktuara për të cilat unë ato nuk i  
6 njoh.

7 PY. Po. Dhe një prej ekzagjerimeve, zmadhimeve ose  
8 zbukurimeve do ishte që z. Syla të thoshte që themeluesit e  
9 partisë së re të PDK-së ishin gjithashtu edhe themeluesit  
10 kryesorë ose fillestarë të UÇK-së. A mund të jetë kjo një prej  
11 qasjeve të tij?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë sepse kërkon  
13 spekulim, hamendësim.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Po pyes për përvojën e vet dhe  
15 prandaj bëra pyetjet e mëparshme.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

17 Z. MISETIC: [Përkthim]

18 PY. Në rregull. Do e bëj vetë edhe një herë pyetjen.

19 Sigurisht që ne duhet që të pyesim z. Syla lidhur me çfarë  
20 mendon ai për këtë zhvillim, apo jo, Dëshmitar?

21 PË. Po përderisa është intervista e atij më së miri mundet  
22 me ju dhënë shpjegimin ai, për arsye se unë nuk kam të drejtë  
23 me fol mbi autorësinë e një shkrimi të tij, po mëse u pyeta  
24 për shkrimin në gjerëna, realisht ka plot libra në Kosovë të  
25 cilat realisht as nuk mundesh me i lexu për shkak të

1 meritokracive të cilat mundohen me ja mbesh vetes për  
2 periudhën e luftës, e në të shumtën e rasteve realiteti nuk  
3 është ashtu. Edhe ne të gjithë në Kosovë edhe ne që kemi qenë  
4 në Shtab të Përgjithshëm, po edhe gjithë ushtarët, edhe gjithë  
5 çlirimtarët kanë pas qejf edhe dëshirë me kon Ushtria  
6 Çlirimtare e Kosovës e strukturume shumë mirë prej ditës parë,  
7 sikur në kushte të paqes. Por, realisht kjo s'ka mujt me u bo,  
8 fatkeqësisht. Por fatmirësisht se lufta përfundoi shumë shpejt  
9 dhe neve na nxuni në vazhdën e përpjekjeve për të qenë një  
10 ushtri tamam e strukturume komplet.

11 PY. Faleminderit z. Bashota.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kam më pyetje të tjera për ju.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi  
14 Barthe ka një pyetje përpara sesa të kalojmë tek ju, z. Dixon.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi  
16 Smith.

17 Pyetje vijuese nga Trupi Gjykses:

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëmëngjes, z. Bashota.  
19 Sapo ju bënë dy pyetje. Ju bëri pyetje avokati i z. Thaçi dhe  
20 këto të janë të pasqyruara në faqen e transkriptit në kohë  
21 reale. Dhe pyetja që ju bë është që:

22 "Mesa dini ju, z. Thaçi a nuk ka lëshuar -- a ka qenë në  
23 gjendje që të lëshojë urdhra për ushtarët në zonë?"

24 Dhe përgjigja që ju jepni është:

25 "Jo."

1 Tani pyetja që kam për juve është kjo:

2 "Pse mendoni ju që z. Thaçi nuk ka pas mundësi ose nuk ka  
3 qenë në gjendje që të lëshojë urdhra për ushtarët në zonë? Ku  
4 e bazoni këtë?"

5 PË. Po një drejtor i drejtorisë politike nuk ka mujt me lëshu  
6 urdhna për veprime ushtarake apo për zonat. Thjesht ka qenë  
7 drejtor i drejtorisë politike. Mbi bazën e kësaj. Ajo ka qenë  
8 kompetencë ekskluzive e Bislum Zyrapit, komunikimi me  
9 komandantët e zonave. Ka qenë shef i shtabit, prandaj.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E keni fjalën këtu për  
11 urdhrat ushtarake, urdhra të tjera operationale apo urdhra në  
12 përgjithësi? Për çfarë e keni fjalën?

13 PË. Po për të gjitha urdhrat që të cilat kanë të bëjnë me  
14 zonat se për zonat nuk besoj që ka ekzistuar një urdhër politik.  
15 Kjo është -- ka qenë fusha dhe veprimtaria e drejtorisë  
16 politike.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po ashtu u pyetët nga  
18 avokati i z. Thaçi në faqen 19 të transkriptit në kohë reale,  
19 dhe këtu citoj:

20 "Ai", pra z. Thaçi, "a mund të lëshonte urdhra për  
21 personat që ndalonin bashkëpunëtorët e pretenduar?"

22 Dhe përgjigja që ju jepni është: "Jo".

23 Ju lutem na e thoni pse mendoni që z. Thaçi nuk ishte në  
24 gjendje ose nuk mundej që të lëshonte urdhra për këta persona?

25 PË. Po pikërisht për të njëjtën arsye që e thashë edhe ma



1 lart, i nderuar Gjyqtar.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju jeni në dijeni, apo jo,  
3 që z. Thaçi u bë kryeministër në Qeverinë e Përkohshme të  
4 Kosovës në prill të vitit 1999. E dini këtë, Dëshmitar?  
5 PË. Po.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ndryshon ndonjë gjë kjo  
7 nga pikëpamja juaj apo situata mendoni që ka qenë e njëjtë  
8 pasi z. Thaçi u bë kryeministër në Qeverinë e Përkohshme të  
9 Kosovës?

10 PË. Nuk - më fal, nuk e kuptova pyetjen, i nderuar Gjyqtar.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja ime e parë ishte kjo:  
12 A jeni në dijeni që z. Thaçi u bë kryeministri i Qeverisë së  
13 Përkohshme të Kosovë në prill të vitit 1999? Në prill ose në  
14 maj 1999. Ju thatë që, z. Thaçi, si shef i drejtorisë politike  
15 nuk ka pasur mundësi që të lëshojë urdhra për ushtarët në zonë  
16 dhe gjithashtu ai nuk ka pasur mundësi që të lëshojë urdhra që  
17 kishin të bënin me bashkëpunëtorët ose kundër  
18 bashkëpunëtorëve.

19 Pyetja ime është kjo: A është gjithashtu e vërtetë ose a  
20 është dëshmia juaj që ai nuk ka pasur mundësi të lëshojë  
21 urdhra për ushtarët në zonë në rolin e vet si kryeministër i  
22 Qeverisë së Përkohshme të Kosovës?

23 PË. Unë mesa e di, për arsye se atëherë kam qenë, e kam thënë  
24 edhe ma herët këtu që kam qenë i shkëputur prej Shtabit të  
25 Përgjithshëm prej shkurtit, por ekskluzivisht e di që z. Thaçi

1 është marrë me kompletimin e kabinetit qeveritar në atë kohë,  
2 edhe mesa unë e mbaj mend i ka pas sfidat e veta kompletimi i  
3 këtij kabineti, për faktin se kjo është bërë mbas kthimit të  
4 Rambujesë, por edhe mbas çlirimit të Kosovës në qershor ku një  
5 pjesë e, domethënë, kur marrëveshja që ka qenë në Rambuje për  
6 krijimin e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, është sabotuar -  
7 s'po di tash a është termi ma adekuat me thonë sabotim apo ka  
8 hjek dorë Lidhja Demokratike e Kosovës që me qenë pjesë e  
9 Qeverisë së Përkohshme. Dhe unë nuk e di, nuk e di për të,  
10 s'muj me -- nuk muj me paragjy nëse vërtetë ka pas mundësi apo  
11 jo, por realisht e di që është marrë me kompletimin e  
12 kabinetit të tij të qeverisë. Ai ka qenë i nominuar, nuk ka  
13 qenë i zgjedhur, po i nominuar.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Atëherë, pasi ju u larguat  
15 nga Shtabi i Përgjithshëm në shkurt, ju nuk e dini në qoftë se  
16 z. Thaçi mund të jepte urdhra si kryeministër i Qeverisë së  
17 Përkohshme të Kosovës apo?

18 PË. Nuk e di. Nuk e di.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Thjesht dua të kuptoj atë  
20 çfarë thatë. Sepse ju po flisni po një periudhë kur z. Thaçi u  
21 bë kryeministër. Megjithatë nuk jam i qartë nga përgjigja që  
22 dëgjova në qoftë se po thoni që z. Thaçi ka pas mundësi që të  
23 japë urdhra apo jo.

24 PË. Nuk e di.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk e dini. Faleminderit.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 Vetëm një çast z. Dixon.

3 Nuk e di a doni që të trajtoni ndonjë prej pyetjeve që u  
4 bënë tani.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk dua të trajtoj asnjërën  
6 prej tyre. Por thjesht për procesverbal dua të them që pyetjet  
7 e mia kanë qenë të kufizuara në fushëveprimin e pyetjeve të  
8 Gjykatësit Mettraux që kishin të bënin me vendimmarrjen  
9 kolektive brenda Shtabit të Përgjithshëm.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
11 [Përkthim] Faleminderit.

12 Ju kërkojmë ndjesë që ju vonuam, Dixon.

13 Z. DIXON: [Përkthim] Pa problem fare.

14 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Dixon:

15 Z. DIXON: [Përkthim]

16 PY. Dëshmitar, kemi disa pyetje të tjera plotësuese. Së pari,  
17 pyetja e parë që vjen nga ana ime ka të bëjë me një pyetje që  
18 ju është bërë nga Gjykatësi Barthe. Është në faqen 60, të  
19 rreshtit 3 [Sipas përkthimit] të transkriptit provizor.

20 "Sipas dëshmisë tuaj ne kuptojmë që ju keni thënë që nuk  
21 ka pasur përgjegjësi zyrtare për të shkruar ose për të  
22 publikuar komunikatat. Unë dua të di se kush e ka pas  
23 kompetencën ose autoritetin brenda Shtabit të Përgjithshëm për  
24 të shkruar ose për të publikuar komunikata në vitin 1996,  
25 1997?"

1 Domethënë kjo është pyetja që ju bëri Gjykatësi dje. Në  
2 përgjigje të pyetjes ju thatë:

3 "Unë kam thënë këtu që ka qenë Naiti, Nait Hasani, sepse  
4 ai më ka thënë që 'ne e kemi trajtu' këtë që prej vitit 1996  
5 deri në arrestimin e Naitit. Sikurse e thashë, unë i kam  
6 kushtuar ca kohë çështjes për të gjetur origjinën e  
7 komunikatave. Nuk e di në qoftë se ka qenë Azem Sylja, Xhavit  
8 Haliti ose persona të tjerë që kanë qenë jashtë shteti, ose në  
9 qoftë se kanë qenë persona brenda Lëvizjes Popullore të  
10 Kosovës, sepse disa komunikata kanë ardhur nga organet e tyre  
11 të shtypit. Kështu që unë nuk e di në qoftë se këta persona  
12 kanë pas autoritet për t'i shkruar komunikatat në atë kohë."

13 A ju kujtohet ta keni dhënë këtë dëshmi dje, dëshmitar?  
14 PË. Po, i nderuar avokat.

15 PY. Në lidhje me pjesëmarrjen e z. Nait Hasani dhe arrestimit  
16 të vet, Gjykatësi Mettraux po ashtu ju bëri pyetje.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Për procesverbal kjo jepet në faqen  
18 107, në rreshtin 7 të transkriptit.

19 I kërkoj Sekretares që të paraqesë në ekran një dokument  
20 që ka të bëjë me arrestimin e z. Hasani, sepse dëshiroj që  
21 t'ju bëj disa pyetje lidhur me kohën e komunikatave, pra kur  
22 janë lëshuar komunikatat.

23 PY. Gjykatësi Barthe ju tregoi dy -- tre komunikata në fakt,  
24 Komunikatën 28, 29 dhe 30 përkatësisht të datave 16 janar  
25 1997, 23 janar 1997 dhe 6 shkurt 1997.

1           Z. DIXON: [Përkthim] Atëherë, le t'i shohim në ekran.  
2 Dokumentet për referencë janë DKV1590 deri në 1591.  
3 PY. Ndërkohë që shfaqet në ekran do t'ju jap pak kontekstin e  
4 dokumentit. Bëhet fjalë për një dokument të *Amnesty*  
5 *International* nga 24 tetor 1997. Është një dokument i cili  
6 është në anglisht, megjithatë do t'ju lexoj pjesët përkatëse  
7 për arrestimin dhe më pas do t'ju bëj disa pyetje lidhur me  
8 kohën e nxjerrjes ose lëshimit të komunikatave.

9           Z. DIXON: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që ta  
10 zmadhonte dokumentin. Dhe fillon tek pjesa ose te paragrafi që  
11 fillon me:

12           "Valët e arrestimeve janë kryer nga policia ..."

13 PY. "Atëherë Nait Hasani është personi i parë i akuzuar në  
14 gjykimin e ri", dhe këtu bëhet fjalë për gjykimin që ka  
15 filluar në tetor 1997. Pra, Nait Hasani "është arrestuar me 28  
16 janar", të 1997-s bëhet fjalë, "dhe brenda 48 orëve ai është  
17 dërguar në spital nga policia për trajtimin e lëndimeve që  
18 kishte marrë në kohën e ndalimit. Më 31 janar ai 'u zhduk'.  
19 Autoritetet e mohuan se kishin dijeni për të derisa ai u shfaq  
20 'përsëri' me 28 shkurt. Atë ditë gjykatësi hetues e pyeti atë  
21 në praninë e avokatit të vet. Nait Hasani pretendoi që është  
22 marrë nga policia prej spitali dhe që është mbajtur në një  
23 vend, adresa e të cilit nuk dihet, ku ai ishte lidhur në  
24 shtratin e vet. Ai pretendonte që është torturuar me  
25 elektroshok me qëllimin e bërjes së deklaratave

1 vetëinkriminuese.”

2 Së pari, dua t'ju pyes, Dëshmitar, a ju kujtohet që z.

3 Hasani është arrestuar me datë 28 shkurt dhe fakti që ai është  
4 zhdukur për pothuajse një muaj. Ju kujtohet kjo?

5 PË. Datën saktë nuk e di, por e di që në fillim të '97-s  
6 është arrestuar.

7 PY. A ju kujtohet që ka pasur pretendime që pasi është  
8 arrestuar në janar, ai më pas është zhdukur për një muaj dhe a  
9 ju kujtohen gjithashtu edhe pretendimi që ai është torturuar  
10 për ca kohë?

11 PË. Po, kam dëgjuar për te.

12 PY. E ke dëgjuar atëherë, domethënë asokohe?

13 PË. Mbas lufte.

14 PY. Por në atë kohë ju keni pas dijeni për arrestimin e vet,  
15 domethënë e keni ditur që ai ishte marrë, është arrestuar dhe  
16 që u zhduk për ca kohë. Kështu?

17 PË. Po. Po, patjetër, po.

18 PY. Atëherë le të shikojmë pak kohën dhe ta shikojmë këtë në  
19 lidhje me komunikatat që ju tregoi Gjykatësi Barthe si pjesë e  
20 pyetjeve të veta. Duhet të jetë e drejtë, apo jo që Komunikata  
21 30 e 6 shkurtit të '97-s nuk mund të jetë nxjerrë nga z.

22 Hasani në qoftë se z. Hasani ka qenë i zhdukur dhe në qoftë se  
23 ka qenë i lidhur me këmbë e me duar në një shtrat, dhe në  
24 qoftë se është torturuar në atë kohë. A është e saktë? I takon  
25 të jetë e saktë kjo, Dëshmitar?

1 PË. Po.

2 PY. Duhet të ketë qenë dikush tjetër atëherë që ka qenë i  
3 përfshirë në lëshimin e kësaj Komunikate konkrete, kështu?

4 PË. Me siguri që po.

5 PY. Ju keni përmendur edhe disa emra të tjerë, keni thënë  
6 gjithashtu që jeni përpjekur që të merrnit vesh se kush i ka  
7 lëshuar këto komunikata. Megjithatë dua që t'ju pyes në qoftë  
8 se e dinit këtë sa i takon kohës. Komunikata tjetër që është  
9 lëshuar, pra, kishte një lloj hendeku kohor, domethënë,  
10 komunikata e radhës ka dalë nga prilli i të njëjtit viti. A ju  
11 kujtohet kjo, Dëshmitar?

12 PË. Nuk më kujtohet kjo. Nuk më kujtohet. Por deshta një  
13 korigjim me ba [E pakuptueshme] ça thatë, se mu --

14 PY. Po, po, patjetër.

15 PË. Se Naiti po i shkrun komunikatat. Dhe unë nuk kam hulumtu  
16 me e gjet se kush po i shkrun. Përderisa e kam dit që ai më ka  
17 thon "Unë po i shkruj", mo s'jam, nuk jam lodh në atë kuptimin  
18 që me i kërku se kush po i shkrun mo ato komunikata.

19 PY. Po. Por, nga ana tjetër duhet të jetë e drejtë apo jo ai  
20 nuk mund ta ketë shkruar komunikatën e shkurtit, domethënë të  
21 6 shkurtit të vitit 1997. Është e saktë kjo?

22 PË. E saktë.

23 PY. Kur keni thënë këtu që "Nuk jam përpjekur që të gjej ose  
24 të konstatoj se kush i ka shkruar vërtetë këto", a ka qenë një  
25 prej arsyeve kjo që duke qenë që ju vetë keni qenë në Kosovë,

1 vetë a keni qenë i shqetësuar që mbase dhe ju mund të  
2 arrestoheshit nga forcat serbe?

3 PË. Po unë prandaj e thashë, jemi shkapërderdhur të gjithë.  
4 Xheladin Gashi ka shku në Drenicë, në Prekaz te komandanti  
5 legjendar Adem Jashari. Unë kam shku në pjesën time,  
6 domethënë, në fshatin e lindjes. Ka qenë zonë ma e kontrolluar  
7 prej forcave -- prej neve që mos me mujt me hy forcat serbe  
8 lehtë pa u vërejtur.

9 PY. Është e saktë apo jo, që ju keni vepruar me shumë kujdes,  
10 me kujdes të skajshëm do thoja po ashtu edhe në sekret ose në  
11 mënyrë të fshehur, në mënyrë të tillë që ju të mos  
12 identifikoheshit dhe të mos arrestoheshit nga forcat serbe. A  
13 ka qenë kështu, Dëshmitar?

14 PË. Po, patjetër.

15 PY. Dhe dukshëm a është e qartë që ju nuk donit që të  
16 arrestoheshit sepse e dinit se çfarë do ju priste në qoftë se  
17 do të arrestoheshit? Pra, në qoftë se do arrestoheshit, do  
18 torturoheshit dhe do t'ju duhet që të nxirrnit informacion nga  
19 punët e brendshme tuaja, kështu?

20 PË. I nderuar, unë mbi kurrizin tim i kam provuar tri herë  
21 arrestimin dhe tri herë torturat më çnjerëzore që mund t'i  
22 bëjë një regjim, siç ka qenë atëherë regjimi i kohës së ish-  
23 Jugosllavisë dhe i Serbisë. Torturat i kemi pasur ma  
24 çnjerëzore pej punëtorëve të sigurimit të shtetit, kështu që  
25 realisht ka qenë një moment ku unë nuk kam mujt me e përballu



1 mo këtë sfidë mo edhe një herë, prandaj edhe kujdesi ka qenë  
2 shumë në maksimum.

3 PY. Pra, gjithmonë ka qenë më mirë që të kesh sa më pak  
4 informacion që të jetë e mundur lidhur me atë se çfarë ndodhte  
5 rreth e qark sepse në qoftë se do kapeshit do detyroheshit që  
6 ta nxirrnit këtë informacion përmes forcës, kështu?

7 PË. Po, nëse s'ke mujt me i përballu torturat është shumë e  
8 natyrshme se edhe ke mujt me fol.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkoj që  
10 kjo faqe, pra ky raport nga një organizatë e të drejtave të  
11 njeriut, *Amnesty International*, më konkretisht të pranohet në  
12 prova gjyqësore përderisa sipas meje përmbush kriteret *prima*  
13 *facie* sa i takon burimit edhe përkon me atë çfarë tha  
14 dëshmitari lidhur me përmbajtjen e dokumentit.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të na  
16 përsërisni dhe një herë numrin e këtij dokumenti?

17 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Është DKV1590 deri në 1591.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë  
19 kundërshtim?

20 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim për këtë  
21 faqe.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Janë dy faqe në fakt, jo një faqe.  
23 Ju lutem të dyja faqet.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
25 DKV1590 deri në 1591 pranohet në prova gjyqësore.

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 34

1           SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do  
2 i caktohet numri i provës 12D94 [Sipas përkthimit]. Ju lutem  
3 na thoni në qoftë se klasifikimi duhet të mbetet konfidencial  
4 apo duhet të riklasifikohet si publik.

5           Z. DIXON: [Përkthim] Mund të riklasifikohet si publik.

6           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem  
7 riklasifikojeni si publik.

8           Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.  
9 Më duhen rreth 20-25 minuta për të vijuar me pyetjet e tjera  
10 të planifikuara për këtë dëshmitar. A do bëjmë pushim tani?

11          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
12 tani do bëjmë 10 minuta pushim. Pas 10 minutash do vijmë në  
13 sallën e gjyqit dhe z. Dixon do përfundojë me pyetjet e veta  
14 gjatë seancës së ardhshme. Faleminderit, tani mund të dilni  
15 nga salla.

16                                 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
18 pushim 10 minuta.

19                                 --- Seanca ndërpritet në orën 10.00

20                                 --- Seanca Rifillon në orën 10.12

21          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem  
22 sillni dëshmitarin në sallë.

23                                 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24          KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, z.  
25 Dixon, vazhdoni me pyetjet tuaja.

1 Z. DIXON: [Përkthim]

2 PY. Z. Bashota, kam disa pyetje që burojnë nga pyetjet që ju  
3 bëri Gjykatësi Mettraux kjo ka të bëjë me udhëheqjen  
4 kolektive. Kjo është pasqyruar në faqen 74, rreshti 21 e në  
5 vijim. Gjykatësi Mettraux ju bëri disa pyetje lidhur me këtë  
6 aspekt.

7 Një pyetje konkrete ishte kur Gjykatësi Mettraux tha:

8 "Besoj se ju e keni thënë, por na e shpjegoni me fjalët  
9 tuaja, a do të thotë kjo që një vendim i Shtabit të  
10 Përgjithshëm pasqyron pikëpamjet e të gjithë anëtarëve?"

11 Kjo ka qenë pyetja. E reflektuar në 79, rreshti 20.

12 Dhe ju thatë:

13 "Po, sigurisht, nëse përfundonte me një vendim, nëse  
14 dilnin me një vendim, nëse përfundonte me një vendi."

15 A ju kujtohet kjo linjë pyetjesh dhe përgjigjesh? Pastaj  
16 do ju bëj unë disa pyetje.

17 PË. Po.

18 PY. Në faqen 80, rreshti 23 ai ju pyet:

19 "A pajtoheni ju me përshkrimin që i ka bërë z. Krasniqi  
20 punës së Shtabit të Përgjithshëm si një punë kolektive dhe  
21 mënyra e funksionimit të tyre si një komandë kolektive?"

22 Kjo ishte një pyetje tjetër që ju bëri Gjykatësi  
23 Mettraux.

24 Dhe ju u përgjigjët:

25 "Të nderuar Gjykatës, është e vërtetë që ne bënim punë

1 kolektive sepse duhet të flisnim dhe për dallimet tona dhe  
2 duhej ndonjëherë që të pajtoheshim edhe për dallimet,  
3 ndryshimet që kishim. Sidoqoftë, secili prej nesh kishte  
4 përgjegjësitë e veta.”

5 Ju kujtohet kjo?

6 PË. Po.

7 PY. Më pas ju bënë më shumë pyetje për konsultimet mes  
8 Shtabit të Përgjithshëm dhe:

9 “Ju thatë, që kur ishte e mundur dhe, e kuptoj që kishte  
10 dhe përjashtime, bëhej një proces konsultimi mes anëtarëve të  
11 Shtabit të Përgjithshëm përpara se të merreshin vendimet?”

12 Dhe ju u përgjigjët dhe thatë:

13 “Po. Çdo temë që trajtohej vijohej me diskutime, pra,  
14 bëheshin diskutime për çdo temë që ngrihej dhe merrej vendim  
15 nëse ishte e nevojshme që të merrej një vendim”.

16 A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe, në faqen 86, ju është bërë pyetje për raportimin nga  
19 terreni dhe rëndësia për t’i marrë këto informacione në mënyrë  
20 që të merrnit vendimet tuaja ju. A ju kujtohet që ju bënë  
21 pyetje për këtë?

22 PË. Po.

23 PY. Disa nga pyetjet që kam unë burojnë pikërisht nga këto.  
24 Pikësëpari sa u takon vendimeve të Shtabit të Përgjithshëm a  
25 është e vërtetë që ju nuk keni vendosur të gjithë së bashku

1 për të gjitha vendimet?

2 PË. E saktë është.

3 PY. A është e saktë që vendimet mund të merreshin dhe, madje  
4 dhe janë marrë, pa qenë ju dhe të tjerët për informuar për  
5 këto vendime?

6 PË. Nuk ka qenë, në shumë raste nuk ka qenë e mundur që të  
7 jemi të gjithë prezent në këto takime. Prandaj dhe vendimet  
8 janë marrë edhe pa prezencën e të gjithëve. Lëvizja e  
9 anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm ka qenë shumë e kufizuar  
10 në atë kohë, prandaj dhe takimet kanë qenë shumë të rralla.  
11 Vetëm për ndonjë çështje shumë, shumë të rëndësishme kemi mujt  
12 me u mbledh, përndryshe mundësia ka qenë shumë e vogël.

13 PY. Po, e kuptoj këtë. Do të flas edhe për Rambujenë pak më  
14 vonë, por a është e vërtetë që për shkak të ofensivave serbe  
15 që ju i keni përshkruar në korrik, gusht, shtator ishte  
16 jashtëzakonisht e vështirë të takoheshit të gjithë së bashku  
17 dhe të vendosnit ju së bashku për vendimet, kështu?

18 PË. E saktë.

19 PY. Pra, vendimet mund të merreshin edhe pa u njoftuar ju  
20 fare për këto vendime, pajtoheni?

21 PË. Po, patjetër.

22 PY. Dhe nuk kishte rëndësi nëse pajtoheshit ose nuk  
23 pajtoheshit ju me vendimin. Ndonjëherë vendimi merrej se duhej  
24 marrë për shkak të situatës.

25 PË. Drejt. E saktë.

1 PY. Pra, a është e drejtë të themi që kur z. Kadri Veseli ka  
2 qenë jashtë vendit që nga nëntori dhe bënte takimet, që i  
3 trajtuam në dëshminë tuaj, me agjencitë homologe të shërbimit  
4 informativ, ai po përpiquej të bashkëpunonte me ta, mund të  
5 ketë marrë dhe vendime, po ju mund të mos keni pasur dijeni  
6 lidhur me këto?

7 PË. Unë e kam thënë edhe ditën që e diskutuam këtë çështje,  
8 nuk më kujtohet nëse ka pas diçka të tillë.

9 PY. Po. Që të jem i drejtë me ju, ju thatë që nuk keni marrë  
10 asnjë raport prej z. Veseli gjatë kohës që ka qenë jashtë  
11 Kosovës, pra, ai nuk ju ka raportuar ju se çfarë bënte atje ku  
12 ndodhej, saktë?

13 PË. Saktë.

14 PY. A është po e saktë se gjatë kësaj periudhe kohore as ju  
15 nuk i keni dërguar atij raporte?

16 PË. E saktë është.

17 PY. Për shembull, ne pamë një dokument gjatë dëshmisë suaj,  
18 dokumenti ka numrin P01109.

19 Z. DIXON: [Përkthim] E vendosim në ekran që ta kuptoni  
20 për çfarë bëhet fjalë. Bëhet fjalë për mbledhjen e 30  
21 dhjetorit të 1998, ka qenë mbledhja e Shtabit të Përgjithshëm.  
22 Ju lutem të vendosim në ekran faqen U002-2861.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Ky dokument nuk buron nga pyetjet  
24 e Gjykatësve. Ky është një dokument që ekipet e Mbrojtjes e  
25 kanë trajtuar gjatë kundërpvetjeve.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është e  
2 drejtë në fakt Gjykatësit nuk e kanë trajtuar këtë dokument.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Unë dua të fokusohem tek disa nga  
4 shembujt për vendimet kolektive. Dhe mbaj mend që në këtë rast  
5 ai ka thënë që nuk ka qenë një vendim kolektiv, prandaj e dua  
6 këtë dokument.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.  
8 Mund ta përdorni atëherë dokumentin.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

10 PY. Dëshmitar, shihni pjesën e sipërme të dokumentit, pika 1  
11 thotë: "Formimi i komisioneve". Dhe thotë: "Këshilli kadrovik  
12 për gradim, këshill për caktimin e vijave kufizuese të zonave  
13 operative". Këto komisione janë krijuar dhe janë formuar në  
14 këtë mbledhje, apo jo?

15 PË. Me siguri. Po unë thashë që nuk më është kujtuar kjo  
16 mbledhja saktë. Unë nuk e di sesi e kam marrë e kam përshkru  
17 këtë dokument. Por realisht e di që komisione ka pas të  
18 formuara. E di që komisione ka pas të formuara. Por që nuk  
19 janë ka funksionale, asnjëna prej këtyre dyjave që i shoh këtu  
20 në letër.

21 PY. Po, unë po ju pyes kështu: A është e vërtetë që z. Kadri  
22 Veseli nuk ka qenë në këtë mbledhje? Nuk ka marrë pjesë në  
23 vendimet që janë marrë për formimin e këtyre komisioneve, apo  
24 jo?

25 PË. Nuk do të thotë me patjetër që është dashtë me qenë në

1 mbledhje dikush nëse ju ka shkru emri këtu. Thjesht këtu është  
2 për komisionet që janë bë atëherë thjesht janë dhënë vetëm ide  
3 se kush mundet me qenë komisionet dhe kur të fillon punimi,  
4 puna e këtyne komisioneve me ia dhënë mundësinë që këto grupe  
5 pastaj me u mbledhë dhe me iplementu këto detyra për të cilat  
6 i kanë marrë. Por, prapë po e them, se këto komisione nuk kanë  
7 mujt me kanë funksionale për shkak të shumë rrethanave.  
8 PY. Po të jem i qartë, z. Kadri Veseli nuk ka marrë pjesë në  
9 diskutimet që janë bërë për formimin e këtyre komisioneve, pak  
10 rëndësi ka a u formuan?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E ka dhënë  
12 përgjigjen. T'u përgjigj. U përgjigj.

13 Z. DIXON: [Përkthim] A mund të përgjigjet dhe një herë ta  
14 kemi të qartë atëherë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].  
16 [Përkthim] Lexo transkriptin nëse nuk të kujtohet  
17 përgjigja. Ju lutem kaloni tek pyetja e radhës.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Nëse është e qartë është e  
19 rëndësishme për mua për vendimet kolektive. Kjo është e  
20 rëndësishme për mua.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë ju po  
22 thoni që një vendim quhet kolektiv vetëm kur janë 100 për qind  
23 e anëtarëve të pranishëm?

24 Z. DIXON: [Përkthim] Jo, nuk është ky qëndrimi im.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po sepse në



1 këtë qëndrim po dilni.

2 Z. DIXON: [Përkthim] Jo, qëndrimi është që në qoftë se  
3 klienti im nuk ka qenë i përfshirë në këtë vendim, atëherë nuk  
4 mund të quhet ky një vendim kolektiv sepse ai nuk ka qenë  
5 përgjegjës, nuk ka qenë në këtë takim.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni tek  
7 pyetja e radhës.

8 Z. DIXON: [Përkthim]  
9 PY. Flasim në një mbledhje që është mbajtur më përpara, bëhet  
10 fjalë për shkrirjen e FARK-ut me UÇK-në. A ju kujtohet që keni  
11 dhënë dëshmi dhe për këtë dhe për personat që kanë qenë të  
12 përfshirë?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtoj. Nuk është pjesë e  
14 pyetjeve të Gjykatësve.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] FARK-u nuk  
16 është trajtuar nga Gjykatësit.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Unë dua të kuptoj përfshirjen e të  
18 gjithë Shtabit të Përgjithshëm në marrjen e këtyre vendimeve.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet ta  
20 kishit bërë këtë gjatë kundërpjetjeve tuaja. Tani mund të bëni  
21 vetëm pyetje që burojnë nga pyetjet e Gjykatësve.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Unë besoj se burojnë nga pyetjet e  
23 Gjykatësit Mettraux sepse ai foli për vendimet kolektive. Edhe  
24 unë dua të eksploroj më shumë këtë pikë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

1           Z. DIXON: [Përkthim] Atëherë do t'i bëj këtë pyetje.  
2   Është bërë një raport nga Shaun Byrnes ku ka folur për  
3   situatën e Shtabit të Përgjithshëm në kohën përkatëse dhe  
4   aftësinë dhe mundësinë e Shtabit të Përgjithshëm për të bërë,  
5   për të marrë vendime, tani dua ta trajtoj këtë me dëshmitarin  
6   për të parë nëse i kujtohet dhe atij e njëjta gjë në këtë  
7   kohë.

8           Nuk është nevoja të shfaqet në ekran, por do t'ju jap  
9   referencën. [REDAKTUAR]

10   [REDAKTUAR]

11   [REDAKTUAR]

12   [REDAKTUAR]

13   [REDAKTUAR]

14           [REDAKTUAR]

15           [REDAKTUAR]

16   [REDAKTUAR]

17   [REDAKTUAR]

18   [REDAKTUAR]

19           Z. DIXON: [Përkthim] E kuptoj që është një dokument  
20   privat po është trajtuar më herët dhe në seanca publike,  
21   sidoqoftë për të qenë të kujdesshëm le të kalojmë në seancë  
22   private.

23           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në  
24   seancë private.

25   [Seancë private]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12 [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

15 PY. Tani dua të flas për bisedimet e Rambujesë se për këtë ju

16 bënë disa pyetje Gjykatësit. Dhe do t'ju pyes, z. Bashota,

17 lidhur me një dokument që ua treguan. Nuk është nevoja ta

18 shfaqim në ekran - është dokumenti P227 - i cili kishte disa

19 nënshkrime ku u vendosë që të vijojë me marrëveshjen. Ju

20 kujtohet kjo?

21 PË. Po.

22 PY. A pajtoheni me mua që në fakt ky ka qenë një vendim i

23 rëndësishëm dhe prandaj u përfshinë të gjithë dhe e

24 nënshkruan.

25 PË. Patjetër.

1 PY. Ishte në fakt një rast përjashtimor? Për këtë ishte e  
2 nevojshme të përfshiheshin të gjithë sepse ishte vërtetë  
3 dokument i rëndësishëm, po një rast përjashtimor, saktë?

4 PË. Patjetër, se ne mendojmë se ai dokument i ka hapur rrugën  
5 dhe perspektivën e Kosovës duke vendosë për nënshkrimin e  
6 dokumentit në Rambuje dhe pastaj u krijuan institucionet e  
7 Kosovës dhe deri tek pavarësia e vendit.

8 PY. Po. A është e saktë që të nesërmen - më falni - më pas u  
9 ndërmoren hapa për të krijuar një qeveri të përkohshme, a ju  
10 kujtohet?

11 PË. Po.

12 PY. Dua t'ju pyes lidhur me diçka që ju pyeti Gjykatësi  
13 Mettraux dhe e kam fjalën për raportimet që merrnit prej  
14 terrenit për çështjet ushtarake të cilat shkonin në Shtabin e  
15 Përgjithshëm dhe sa e rëndësishme ishte kjo. A ju kujtohen  
16 pyetjet për këtë?

17 PË. Po.

18 PY. A është e vërtetë që, sigurisht, ju përpigëshit të  
19 merrnit sa më shumë informacione nga terreni, por që nuk ishte  
20 gjithmonë e mundshme kjo. Nuk ishte e mundshme që ju ta dinit  
21 gjatë gjithë kohës se çfarë po ndodhte në terren?

22 PË. Po, kryesisht informacionet janë transmetuar përmes  
23 zonave deri tek shefi i shtabit. Por po e them dhe po e  
24 përsëris prapë, se mundësia e lëvizjes në atë kohë në zona të  
25 luftës ka qenë realisht shumë e vështirë me marrë informacione

1 në kohë dhe në momentin kur na janë paraqitë problematikat e  
2 ndryshme. Por kryesisht, po.

3 PY. Pra, ndonjëherë thjesht duhet të merrnit informacione pa  
4 e marrë informacionin nga terreni se përndryshe do  
5 paralizoheshit, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Një çështje e fundit lidhur me pyetjet e Gjykatësit  
8 Mettraux që është reflektuar në faqen 91, rreshti 23 i  
9 transkriptit. Ju bënë shumë pyetje për z. Kadri Veseli dhe  
10 pozitën që pati ai si shef i drejtorisë së shërbimit  
11 informativ.

12 Mesa ju kujtohet ju, drejtoria e shërbimit informativ në  
13 atë kohë njihej si G2?

14 PË. Unë e thashë edhe këtu, nuk më kujtohet se ka qenë  
15 drejtoria e shërbimit informativ si G2. Thashë këtu,  
16 organizimet që janë bë, domethënë, ka qenë, kanë qenë të  
17 ardhun nga Bislum Zyrapi dhe realisht nuk i mbaj mend saktë  
18 emërtimet të cilat kanë qenë në këto G1, G2, G3 e me radhë,  
19 por nuk e di, për këtë s'mund ta them.

20 PY. Është e drejtë, po. Sa i takon shërbimit, drejtorisë së  
21 shërbimit informativ që ju thatë se u krijua pas nëntorit  
22 1998, ju e dini që z. Kadri Veseli ka qenë shef i kësaj  
23 drejtorie, keni dhënë dëshmi për këtë. Por ama ju personalisht  
24 nuk kemi marrë asnjë raport prej tij në këtë cilësi?

25 Z. HALLING: [Përkthim] Është bërë pyetja, ka marrë

1 përgjigje.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

3 Mund të përgjigjeni, Dëshmitar.

4 DËSHMITARI: Unë nuk kam marrë asnjë raport nga z. Veseli.

5 Z. DIXON: [Përkthim]

6 PY. Dhe as ju nuk i keni dërguar atij ndonjë raport?

7 PË. Jo.

8 PY. Faleminderit.

9 Kam një çështje të fundit tani që lidhen me pyetjet e  
10 Gjykatësi Gaynor, kjo është e pasqyruar në transkriptin  
11 provizor faqja 124, rreshti 9 e në vijim. Gjykatësi thotë:

12 "Pyetja e dytë që kam është me informacionet që merrte --  
13 informacionet e zbulimit që merrte Shtabi i Përgjithshëm."

14 Dhe pastaj ai ka parë disa pjesë të intervistës suaj ku  
15 ju keni përmendur informacionet lidhur me Tahir Zemajn dhe  
16 mënyrën sesi e keni marrë ju informacionet lidhur me të. Dhe  
17 ai më pas ju pyeti dhe ju tha:

18 "Atëherë ... çfarë, cili ishte ky shërbim informativ apo  
19 shërbim i zbulimit që i jepte informacione Shtabit të  
20 Përgjithshëm?"

21 Në rreshtin 24. Dhe ju u përgjigjët dhe thatë:

22 "E kam specifikuar në shënimet e mia që këto janë disa  
23 persona që ... bënin punë për zbulimin. Unë nuk e kam ...  
24 idenë se çfarë ka qenë shërbimi i zbulimit. As nuk e kuptoj  
25 mirë ... dhe sot e kësaj dite këto. Po për shkak të rëndësisë

1 së informacionit që përcillej, unë kam supozuar që kanë qenë  
2 persona që punonin në shërbimin e zbulimit.”

3 Dhe pastaj Gjykatësi Gaynor ju pyeti dhe ju tha:

4 “A ia dorëzonin ata këto informacione Shtabit të  
5 Përgjithshëm?”

6 Ju keni thënë:

7 “Jo, këtë informacion ma kanë dhënë mua personalisht. Unë  
8 nuk ua di emrat, thjesht kam supozuar.”

9 Tani, unë dua të vazhdoj këtu, kur jeni takuar me këta  
10 persona, me personat në fjalë, i pyetët ju për kërkohj punonin?

11 PË. Jo, jo, nuk e kam pyet. Thjesht veç e ka dhënë si  
12 informacion të cilin për mua personalisht më është dukur shumë  
13 interesant dhe se s’kisha pas informacione për të dhe kam  
14 supozuar se janë pikërisht njerëz të cilët realisht punojnë  
15 për shërbimet inteligjente. Po jo që ata më kanë thënë. Dhe  
16 nuk i njoh si persona. Po thjesht kështu i kam hamendësu.

17 PY. Ky ishte informacion që ishte dhënë më herët. Po nuk  
18 është se ka pas ndonjë raport me shkrim, apo jo, Dëshmitar?

19 PË. Jo, jo, as me shkrim as -- edhe kjo ka ndodhë, ka ndodhë  
20 në qat rast. S’kemi pas me shkrim asgjë.

21 PY. Kur e keni marrë këtë informacion, ju këtë informacion  
22 nuk ia keni përcjellë askujt, apo jo?

23 PË. Jo, jo. Ky ka qenë kështu, thashë, komunikim i  
24 rastësishëm. Nuk ka qenë me naj qëllim të caktuar takimi.

25 Thjesht informacion, po që për mua më është duk shumë



1    interesant.

2    PY.    Është e drejtë apo jo që në atë kohë ju nuk keni pasur  
3    informacion për ndonjë shërbim zbulimi ose informativ që  
4    funksiononte në UÇK, që ka qenë pjesë e UÇK-së? A është e  
5    saktë kjo?

6    PË.    Jo, s'kam pas, jo.

7    PY.    Faleminderit, z. Bashota. Nuk kam pyetje tjera për ju.

8            Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

9            KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
10   z. Dixon.

11           Z. Roberts.

12           Z. ROBERTS: [Përkthim] Më duhen maksimumi 5 deri në 10  
13   minuta.

14                    Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Roberts:

15           Z. ROBERTS: [Përkthim]

16   PY.    Mirëmëngjes, z. Bashota. Unë jam Geoff Roberts.

17   PË.    Mirëmëngjesi.

18   PY.    Jam avokat i z. Selimi.

19           Kam pak pyetje për ju, thjesht për të sqaruar disa prej  
20   përgjigjeve që keni dhënë në pyetje të Gjykatësve dje. Do ju  
21   kujtoj për atë çfarë keni thënë në përgjigje të pyetje të  
22   Gjykatësve dhe pastaj do ju bëj pyetjet e mia.

23           Në faqen 57 të transkriptit të përkohshëm të ditës së  
24   djeshme, ju bë një pyetje se kush ka qenë anëtar i Shtabit  
25   Qendror në vitin 1997 dhe ju thoni:

1            "... unë kam qenë i vetmi nga Shtabi Qendror që isha në  
2 Kosovë". Pas largimit të Nait Hasanit, pas arrestimit të tij.  
3 "Pas arrestimit të tij Shtabi i Përgjithshëm ose Shtabi  
4 Qendror atëherë ishte i shkapërdredhë sa i takon aktiviteteve  
5 të veta."

6            Ndërkohë që Gjykatësi Gaynor ju pyet:

7            "Ju po e thoni këtë se ju dhe z. Selimi keni qenë të  
8 vetmit anëtarë të Shtabit Qendror që keni qëndruar që keni  
9 mbetur në Kosovë ... apo jo?"

10          Përgjigja që ju jepni është:

11          "Po. Por nuk ka pasur asnjë takim zyrtar në mënyrë të  
12 tillë që të caktoheshin Rexhep Selimi dhe Lahi Brahimaj si  
13 anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm. Plaku tha që ai duhej të  
14 caktohej atje po nuk u trajtua më kjo çështje sepse ai iku për  
15 në Shqipëri."

16          A është e qartë kjo, është e qartë a është dëshmia juaj e  
17 djeshmja?

18 PË. Po.

19 PY. Plaku ishte Xheladin Gashi, apo jo, Dëshmitar?

20 PË. Po, po.

21 PY. Gjykatësi Gaynor vazhdoi me pyetje të tjera dhe sa i  
22 takon z. Selimi ai tha që ai mendohej ose supozohej që të  
23 bëhej anëtar, por ai nuk u bë anëtar sepse ju nuk u takuat,  
24 nuk u mbledhët dhe ju thatë, po, e konfirmuat këtë, a është e  
25 saktë kjo?

1 PË. Po.

2 PY. Më pas dhe, për procesverbal kjo jepet në faqen 97,  
3 Gjykatësi Mettraux ju bëri një pyetje të ngjashme lidhur me  
4 anëtarësinë e z. Selimi në Shtabin Qendror. Ju thatë:

5 "Përderisa më pyetët, përderisa ju pyetët për Rexhep  
6 Selimin, thotë Gjykatësi Barthe, juve si e keni kuptuar,  
7 Rexhep Selimi kur është bërë anëtar i Shtabit Qendror ose i  
8 Shtabit të Përgjithshëm kur ka ndodhur kjo gjë?"

9 Ndërkohë që në përgjigje ju thoni që:

10 "Nuk më kujtohet se kur ka ndodhë ekzaktësisht kjo gjë."

11 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 PY. Për të qenë i qartë, kur flisni për takimin në Negrovç,  
14 ky është takimi në mes të 1998, apo jo, Dëshmitar? Diku nga  
15 maji ose qershori i këtij viti?

16 PË. Po, aty. Aty përafërsisht.

17 PY. Pra, dëshmia juaj është shumë e qartë, se mesa ju  
18 kujtohet juve, z. Selimi nuk ka qenë anëtarë i Shtabit Qendror  
19 deri në vitin 1997 deri në takimin që në kohën më të afërt të  
20 mundshme ka ndodhur diku nga mesi i 1998?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë, është  
22 keqinterpretim i dëshmisë.

23 Z. ROBERTS: [Përkthim] Unë thjesht po e evidentoj, po e  
24 pyes dhe një herë dëshmitarin për ta sqaruar.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

1 Kundërshtohet.

2 Mund të vazhdoni. Mund të jepni përgjigje.

3 DËSHMITARI: Ma jep dhe një herë se u hutova.

4 Z. ROBERTS: [Përkthim]

5 PY. Pa diskutim fare. Do ta lexoj dhe një herë:

6 "Pra, dëshmia juaj është shumë e qartë, se mesa ju  
7 kujtohet ju z. Selimi nuk ka qenë anëtar i Shtabit Qendror në  
8 1997 deri tek ai takim që ka ndodhur në jo më përpara sesa  
9 mesit të vitit 1998?"

10 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

11 PË. Unë dua me sqaru, i nderuar avokat, se porosinë e  
12 Xheladin Gashit, po realisht nuk ka mujt me qenë anëtar i  
13 shtabit në qoftë se nuk ke mujt me e rikonfirmu një gjë të  
14 tillë. Kështu që deri më atë ditë, Rexhep Selimi nuk ka qenë  
15 anëtar i shtabit. Atë ditë kur është bë në Nagrovc besoj që  
16 atje i kemi shtjellu këto ma herët.

17 PY. Faleminderit. Për ta verifikuar plotësisht. Më vonë në  
18 pyetjet e tjera që ju bën Gjykatësi Mettraux jepet më vonë  
19 në faqet përkatëse të transkriptit, ai thotë që:

20 "A pajtoheni me supozimin që në 1997-n dhe më përpara, ju  
21 dhe Rexhep Selimi keni qenë të dy anëtarë të vetëm të Shtabit  
22 Qendror të pranishëm ose prezent në Kosovë?"

23 Dhe ju u përgjigjët:

24 "Po, në vende të ndryshme, jo në një vend."

25 Tani dua që ta sqaroni pak këtë sepse duket sikur ka

1 përplasje ndërmjet përgjigjes që dhatë tani dhe përgjigjes që  
2 keni dhënë më herët?

3 PË. Jo unë --

4 PY. Jo, vazhdoni. Domethënë, dua t'ju pyes që a pajtoheni me  
5 propozimin e Gjykatësit që z. Selimi ka qenë anëtar i 1997-s,  
6 pra, ka qenë i Shtabit Qendror? Ndërkohë që përgjigja që sapo  
7 dhatë përpara një çasti nuk ishte kjo, ishte e ndryshme.

8 PË. Jo, jo. Unë këtu e kam sqaru, po nuk di sa është në  
9 procesverbal dhe sa është mbajt mend. Me aq sa mu më kujtohet  
10 përgjigja u kanë kështu: Në qoftë se merret se Rexhep Selimi -  
11 - fjala është në qoftë se merret nga ose konceptohet nga kjo  
12 Gjykatë, se Rexhep Selimi është pranuar anëtar i Shtabi i  
13 Përgjithshëm vetëm me një fjalë të Xheladin Gashit kur ka shku  
14 për në Shqipëri, atëherë unë e Rexhep Selimi kemi qenë në  
15 vende të ndryshme gjatë asaj periudhe të luftës. Por nuk ka,  
16 për mu personalisht, nuk ka mujt me kanë anëtar i Shtabit të  
17 Përgjithshëm përderisa nuk është zgjedhë, domethënë, nga një  
18 forum, nga një grup. Kam qenë, atëherë kam qenë i vetmi dhe  
19 kam mujt as me e transmetu atij dhe as me u taku për çështje  
20 organizative me të.

21 PY. Besoj që kjo është e qartë. Ju nuk është jeni takuar me  
22 të, nuk është se keni pas kontakt me të në 1997, këtë po  
23 thoni, kjo është dëshmia juaj, se keni qenë në vende të  
24 ndryshme. A keni thënë këtë, është e saktë kjo, Dëshmitar?

25 PË. Po, po.

1 PY. Dhe, për pasojë, ju nuk keni pas ndonjë arsye që të  
2 prisnit ai të kishte ndonjë njohuri lidhur me veprimtaritë e  
3 Shtabit të Përgjithshëm ose Shtabit Qendror në 1997, kështu,  
4 Dëshmitar?

5 PË. Saktë.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.  
7 Nuk kam pyetje tjera.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
9 z. Roberts.

10 Znj. Alagendra.

11 Pyetje vijuese të palës tjetër nga znj. V.

12 Alagendra:

13 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

14 PY. Mirëmëngjes, z. Bashota.

15 PË. Mirëmëngjesi.

16 PY. Dje, Gjykatësi Mettraux ju bëri disa pyetje lidhur me  
17 anëtarët e Shtabit Qendror, dhe në faqen 98 të transkriptit të  
18 përkohshëm, ju keni thënë që Jakup Krasniqi nuk ka qenë  
19 asnjëherë pjesë ose anëtar i Shtabit Qendror. A është dëshmia  
20 juaj kjo, keni thënë këtë? Është e saktë kjo?

21 PË. Nuk e di, unë s'kam thënë asnjëherë. Për periudhën e  
22 mëhershme, po.

23 PY. Nuk e di e kuptuat pyetjen apo jo? Keni thënë që Jakup  
24 Krasniqi nuk ka qenë anëtar i Shtabit Qendror?

25 PË. A Shtabit Qendror? Në rregull është. Po.

1 PY. Atëherë Gjykatësi Mettraux ju bëri pyetje lidhur me  
2 anëtarët e Shtabit Qendror. Dhe në faqen 89 të transkriptit të  
3 djeshëm, qenë anëtar thuhet që ju keni konfirmuar që Jakup  
4 Krasniqi asnjëherë nuk qenë anëtar i Shtabit Qendror, a është  
5 e saktë kjo? A është dëshmia juaj kjo, Dëshmitar?

6 PË. Korrekt.

7 PY. Më pas u pajtuat me Gjykatësi Mettraux, në faqen 101 të  
8 transkriptit dhe thatë që, në qoftë se dikush e dinte se kush  
9 ishin anëtarët e Shtabit Qendror ose Shtabit të Përgjithshëm  
10 në atë kohë, ky person do ishte Azem Syla sepse Azem Syla  
11 ishte komandant i atij grupi. A ju kujtohet ta keni thënë  
12 këtë?

13 PË. Po.

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të  
15 paraqesë në ekran tani P847. Mendoj që në versionin në shqip  
16 faqja përkatëse që dua që të paraqitet është faqja 2 dhe  
17 kolona e mesit. Ndërkohë që në versionin në anglisht është  
18 faqja 3. Besoj se në versionin në shqip duhet të kalojmë më  
19 poshtë në faqe. Po, këtu. Faleminderit.

20 PY. Gjykatësi Mettraux ju tregoi këtë dokument, Dëshmitar dhe  
21 në faqen 95 të transkriptit të përkohshëm. Arsyja që pse ju  
22 tregua kjo pjesë është që Azem Syla renditë anëtarët e Shtabit  
23 të Përgjithshëm dhe ai thotë që anëtarët e Shtabit Qendror  
24 kanë qenë Azem Syla, Sokol Bashota, Kadri Veseli, Xheladin  
25 Gashi, Ali Mehmeti, Xhavit Haliti, Hashim Thaçi, Rexhep

1 Selimi, Lahi Brahimaj dhe një shok tjetër. A e shikoni këtë  
2 pjesën, Dëshmitar? Domethënë, unë jam e interesuar për këtë  
3 pjesën "një shokë tjetër". E shikoni, Dëshmitar?

4 PË. Nuk di nëse e kemi thënë ju, po mu në përkthim më erdhe  
5 këtu Ali -- ndryshe më erdhe, po është Ali Ahmeti fjala. Nëse  
6 e cituat saktë ju në anglisht. Po mu në shqip më erdh mbiemri  
7 ndryshe. Fjala është për Ali Ahmetin.

8 Ndërsa sa i përket pyetjes juaj, unë nuk e di për kën  
9 është fjala këtu. Për cilë, për çka ka dash me thënë Azem Syla  
10 në këtë rast.

11 PY. Në rregull. Për këtë jam e interesuar, Dëshmitar.

12 PË. Po.

13 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani le të kalojmë në fund  
14 të dokumentit. Në versionin në shqip.

15 PY. Do shikoni në fund që kjo intervistë është realizuar më 2  
16 tetor 1999, e shikoni, Dëshmitar? Është e saktë kjo?

17 PË. Po.

18 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani do kërkoja për  
19 Sekretaren që të paraqesë në ekran dokumentin 067269 deri në  
20 067710-ET e Rishikuar, faqja konkrete për të cilën jam e  
21 interesuar është faqja 480 e PDF-së dhe referenca për këtë  
22 është 067709.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ky është një  
24 dokument i cili nuk është treguar gjatë pyetjeve të  
25 Gjykatësve. Shkon përtej fushës së veprimit të pyetjeve.



1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

2 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në  
3 mënyrë të tillë që unë të bëj pyetjen pasuese që lidhet me  
4 pyetjet e Gjykatësve, më duhet të paraqesë këtë dokument në  
5 ekran dhe kjo bën të mundur pyetjet e mia të mëtejshme për  
6 dëshmitarin.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].  
8 [Përkthim] Shkon përtej fushëveprimit të pyetjeve të  
9 Gjykatësve.

10 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dje  
11 Gjykatësi Mettraux --

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk dua  
13 komente shkon përtej fushës së veprimit të pyetjeve të  
14 Gjykatësve.

15 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Në rregull. Do shikojmë  
16 dokumentin tjetër.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Përpara se ta bëni këtë,  
18 znj. Alagendra, a mund të më thoni në qoftë se qëndrimi juaj  
19 është z. Krasniqi nuk ka qenë anëtar i Shtabit Qendror në fund  
20 të 1996 ose në fillim të 1997 dhe për rrjedhojë ai ka gënjyer  
21 nën betim përpara TPNJ-së?

22 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
23 qëndrimi ynë është që z. Krasniqi nuk ka qenë anëtar i Shtabit  
24 Qendror.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Domethënë, ka gënjyer

1 përpara TPNJ-së?

2 ZNJ.V. ALAGENDRA: [Përkthim] Jo, ka gënjyer. Por po them  
3 që në shumë raste Dëshmitarëve i është dhënë mundësia që të  
4 rishikojnë deklaratat e mëparshme dhe të bëjnë korrigjimet e  
5 tyre.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë po flas këtu për  
7 dëshminë përpara Trupit Gjykses, për të vërtetën dhe në qoftë  
8 se ai ka thënë të vërtetën apo jo për këtë po flas.

9 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar, e di këtë gjë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. Mund të  
11 vazhdoni.

12 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Në intervistën e Azem Sylës  
13 që ë botuar më datë 25 shtator, z. Bashota, ai ka thënë si më  
14 poshtë:

15 "UÇK- ja është themeluar në dhjetor të 1993. Njerëzit që  
16 kanë marrë pjesë në këtë takim janë Sokol Bashota, Xhavit  
17 Haliti, Xheladin Gashi, Ali Ahmeti, një tjetër shok emrin e të  
18 cilit nuk e përmendim dot për momentin dhe unë vetë."

19 Pra, që ta dini kjo është një intervistë e cila është  
20 dhënë më datë 25 shtator 1999. A jeni në dijeni të kësaj  
21 interviste?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë. Po lexon nga i  
23 njëjti dokument që nuk u lejua që ta tregonte në ekran. Shkon  
24 përtej fushës së veprimit të pyetjeve të bëra nga Trupi  
25 Gjykses.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Qëllimi i  
2 pyetjeve tani është që të bëhen pyetje që kanë buruar nga  
3 pyetjet e Gjykatësve.

4 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. U  
5 bë një pyetje nga Gjykatësi Mettraux që ishte shumë  
6 sugjestive, që ishte shumë orientuese dhe pyetja kishte të  
7 bënte me "kolegun tjetër" ose "shokun tjetër" kush ishte ky.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem mund  
9 ta bëni në mënyrë më të drejtpërdrejtë pyetjen. Thojini kush  
10 është ky person.

11 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Do ta bëj ndryshe. Kisha  
12 një propozim tjetër për t'ia bërë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem  
14 bëjeni pyetjen si ju thashë.

15 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]  
16 PY. A e dini ju se kush ishte ky shoku ose kolegu tjetër që  
17 përmend z. Sylja, emrin e të cilit ai nuk e jep, z. Bashota?  
18 PË. Jo, nuk e di.

19 PY. Përmendët që Nait Hasani u arrestua në janar 1997, a  
20 është e saktë kjo, në fillim të janarit, kështu?

21 PË. Po.

22 PY. A ka qenë ai anëtar i Shtabit Qendror?

23 PË. Po.

24 PY. Ai është burgosur nga autoritetet serbe që nga fillimi i  
25 janarit të 1997, a është e saktë kjo, e kam saktë këtë?

1 PË. Saktë, saktë.

2 PY. Asokohe, pra, në kohën kur është bërë intervista e z.

3 Sylja, duke marrë parasysh intervistën, domethënë, në tetor të

4 1999, Nait Hasani ishte ende në burg në Serbi në këtë kohë,

5 apo jo, është e saktë kjo?

6 PË. Po.

7 PY. Në faqen 27 të transkriptit të ditës së sotme, në

8 rreshtin 14, ju thatë që keni dëgjuar për torturat që ka

9 vuajtur Nait Hasani gjatë ndalimit ose arrestimet nga

10 autoritetet serbe, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

11 PË. E saktë. Kështu është vepru me të gjithë të burgosurit

12 politik të asaj kohe.

13 PY. Dhe ekspozimi ose bërja me dije e Nait Hasanit si anëtar

14 i Shtabit Qendror të UÇK-së, ndërkohë që ka qenë në burgjet

15 serbe, do ta kishte vendosur Nait Hasanin në një rrezik edhe

16 më të madh. A pajtoheni me këtë? Dhe ju në faqen 29 të

17 transkriptit të sotëm, thatë që regjimi serb i ka vendosë

18 shqiptarët e Kosovës në torturat më çnjerëzore të mundshme, a

19 është e saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Po, e saktë. Ka mujt me pas pasoja shumë të mëdhaja.

21 PY. A pajtoheni me mua se fakti që Nait Hasani ka qenë në

22 duar e serbëve, në arrestim, në burg, ka qenë një arsye e

23 fortë sepse emri i tij nuk është dhënë në mënyrë publike ose

24 nuk është përmendur shprehimisht nga Azem Sylja në atë

25 intervistë?

1 PË. Ka të ngjarë. Por realisht përderisa është intervista e  
2 Azem Sylës, s'po muj me komentu këtë qëllimin. Nëse e ka pas  
3 këtë qëllim, atëherë për mua është një qëllim fisnik.

4 PY. Në shtator dhe në tetor të 1999, kishte kaluar thujse më  
5 shumë se një vit kur Jakup Krasniqi ishte anonçuar ose ishte  
6 prezantuar publikisht si zëdhënësi i UÇK-së, domethënë, se ai  
7 është prezantuar si zëdhënës në qershor të 1998. A e kam saktë  
8 këtu unë, Dëshmitar?

9 PË. Po, saktë.

